



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General Secretary

Nr. 49 /2026
Datë: 04 / 05 /2026

Në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gz,nr.7,01 Mars 2019), duke u bazuar në nenin 65 (paragrafi 1, 2, 3 dhe 4) të Ligjit Nr. 08/L -197 për Zyrtarët Publik si dhe nenin 11 (paragrafin 4) të Rregullores Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë nxjerr këtë:

V E N D I M

për transferimin e përhershëm të nëpunësit civil për interes të institucionit

1. Z. Lulzim Beqiri, nga pozita aktuale Drejtor i Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave, në Ministrinë e Drejtësisë, për interes të institucionit transferohet përhershëm brenda të njëjtës kategori të shërbimit civil, në pozitën Drejtor i Departamentit Ligjor në Ministrinë e Drejtësisë.
2. Në zbatim të Rregullores ZKM-Nr.10/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Drejtësisë, për shkak të domosdoshmërisë së plotësimit të kësaj pozite, në pajtim me legjislacionin në fuqi, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.
3. Obligohet Divizioni për Burime Njerëzore dhe Departamenti për Buxhet dhe Financa që të ndërmarr të gjitha veprimet për zbatimin e këtij vendimi dhe pagesën e nëpunësit sipas pagës së pozitës në të cilin është transferuar.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Në zbatim të Rregullores ZKM Nr. 10/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Drejtësisë, dhe për shkak të domosdoshmërisë së plotësimit të pozitës dhe në interes të institucionit, është vlerësuar dhe është vendosur transferimi i përhershëm i nëpunësit civil Z. Lulzim Beqiri, brenda së njëjtës kategori të shërbimit Civil, nga pozita aktuale Drejtor i Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave në pozitën Drejtor i Departamentit Ligjor në Ministrinë e Drejtësisë.

Në mbështetje të nenit 65 (paragrafi 1,2,3 dhe 4) të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe nenit 11 (paragrafi 4) të Rregullores Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, për shkak të domosdoshmërisë së plotësimit të kësaj pozite, në pajtim me legjislationin në fuqi dhe pas marrjes së pëlqimit nga nëpunësi civil, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ridvan Hoti

Sekretar i Përgjithshëm



Vendimi u dërgohet:

- Z. Lulzim Beqiri;
- Kabinetit të Zëvendëskryeminstres dhe Ministres së Drejtësisë në detyrë;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave;
- Departamentit Ligjor;
- Departamentit për Buxhet dhe Financa;
- Divizionit për Burime Njerëzore;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.